



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**Sekret
RHK
Ekzemplar Nr. _____**

**URDHËZIM
NR.1 DATË 21.04. 2006**

**PËR
PERGJIMET**

Me synim, për të unifikuar:

- mënyrën e realizimit të përgjimit, si mjet i kërkimit të provës, duke garantuar liritë dhe të drejtat e njeriut;
- rregullat për lëvizjen, regjistrimin, ruajtjen e sekretit dhe të dokumentacionit të dalë nga procesi i përgjimit;
- mënyrën e komunikimit me operatorët e telekomunikimit;
- mënyrën e asgjësimit të materjaleve të përgjimit.

Në mbështetje, te neneve 24 pika 4; 221 e vijues të K. Pr. Penale; të nenit 8, pika 2 e vijues të ligjit nr. 8737, datë 12. 02. 2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në R.Sh.", të ndryshuar dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9157, datë 04. 12. 2003, "Për Përgjimin e Telekomunikimeve";

U D H Ë Z O J:

I. PËRKUFIZIME

Në zbatim të këtij udhëzimi termat e mëposhtëm kanë këto kuptime;

1. "Sistemi i përgjimit procedural penal"* janë pajisjet e përgjimit që ndodhen në ambientet e Qendrës së Përgjimeve, të veçuara në dy dhoma.

1.1 Në "Dhomën A" janë të instaluar pajisjet fundore të sistemittë ndërlihdhjes me mikrovalë, serverat kryesorë të përgjimeve dhe terminalët komanduese të sistemit të përgjimit, në administrim të' punonjësve të Seksionit të Përgjimit të Telekomunikimeve dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative (SPTMSHI-ve) të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

1.2 Në "Dhomën B" janë të instaluar terminalët e transkriptimeve, në administrim të punonjësve të SPTMSHI-ve të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

2. "Material i përgjuar" është çdo material i rregjistruar në audio, kompjuter/server apo letër me anë të procesit të përgjimit, si dhe çdo fragment (pjesë e shkëputur), kopje e pjeshme ose përmbledhje e materialit të" identifikuar si produkt i procesit të përgjimit procedural penal.

3. "Parimi i propoçlonalitetit" është ballancimi i të drejtës ndërmjet interesit të përgjithshëm në ndjekjen penale ne një çështje dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të individit. Në respektirnin e këtij parimi, prokurori, në çdo rast, duhet të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse masa e marrë prej tij ose masa që ai i kërkon gjykatës është në proporcion me objektivin që synohet për të arritur me anë të përgjimit.

4. "Vende private", konsiderohen vendet ku personit i garantohet e drejta e jetës private, e cila nënkupton "të drejtën për te jetuar ashtu siç do vetë personi në të gjitha situatat, pa iu ekspozuar publicitetit për çdo gje që ka të bëjë me shëndetin e personit, me bindjet e tij filozofike, fetare, morale, me jetën familjare dhe sentimentale, me lidhjet miqësore, si dhe me jetën profesionale dhe materiale", (koment i nenit 8 te Konventës Evropiane "Për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut").

II. GARANCITË E KOMUNIKIMIT DHE OBJEKTIVAT E PËRGJIMIT

1. Liria dhe fshehtësia e korespondencës ose e çdo mjeti tjetër komunikimi janë të garantuara (neni 36 i Kushtetutës). Kufizimi i kësaj të drejte - parashikuar në nenin 17/1 të' Kushtetutës dhe në nenet 221-226 të K. Pr. Penale - bëhet për të mbrojtur interesat publike ose për të mbrojtur të drejtat e personave të tjerëve, duke respektuar parimet e nevojshmërisë, proporcionalitetit, ruajtjes së sekretit dhe objektivitetit në kryerjen e tij.

2. Përgjimi - ndërhyrja e fshehtë për të kapur, degjuar dhe regjistruar përmbajtjen e komunikimit dhe të dhëna që lidhen me të, ndërmjet pikës së nisjes dhe pikës së mbërritjes - si metodë e posaçme hetimore të përdoret si nje mjet i efektshëm për kërkimin e provës, duke plotësuar kushtet e parashikuara në ligj, neni 221 e vij"ues i K. Pr. Penale.

3. Përgjirnet e komunikimeve telefonike, ambjentale ose në forma të tjera të kryhen në kushte sa më të natyrshme, me synim për të rritur efektivitetin e këtij mjeti për sigurirnin e provave, identifikimin e veprimtarisë kriminale dhe te autoreve të saj, si dhe vënien e tyre para drejtesisë. Prokurorët dhe oiicerët e policisë gjyqesore duhet të synojnë:

3.1 përgjim të komunikimeve, në ambjente të ndryshme: si në banesë, autoveturë, lokale etj, të personave dhe grupeve në k

3.2 përgjim të komunikimeve të çfarë do lloji, telefonike apo telegrafike, si dhe të të gjitha transmetimeve në distancë, si: telefon stacionar, celular, në rrjet, faks, etj;

3.3 përgjim në forma të tjera të telekomunikimit dhe përgjim të flukseve në sisteme informatike apo telematike, në internet, e-mail, etj,

III. KUSHTET PËR TË AUTORIZUAR PËRGJIMET

1. Pergjimi i telekomunikimeve në vende private mund të autorizohet

nga prokurori në kushte emergjente ose mund ti kërkoje autorizim gjykatës, vetëm kur sigurohet për ekzistencën e dy kushteve bazë që janë:

1.1 Në ngarkim të personit që do të përgjohet ka të regjistruar një procedim penal, për një nga llojet e veprave penale që parashikon neni 2.21/1 të K. Pr. Penale, siç janë:

- për krimet e kryera me dashje, për të cilat parashikohet dërimi me burgim jo më pak, në maksimum se shtatë vjet, ose;
- për kundravajtjet penale të fyerjes dhe kanosjes të kryerja me mjete të telekomunikimit.

1.2 Kushti tjetër është kur:

- përgjimi është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara, dhe;
- ka prova të mjaftueshme për vertetimin e akuzës.

Vetëm konstatimi i ekzistencës njëkohësisht të këtyre dy kushteve mund të vlerësojë të ligjshëm lëshimin e autorizimit për përgjim.

2. Përgjimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video në vende putoike dhe përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendodhjes mund të autorizohet nga prokurori, vetëm kur sigurohet se në ngarkim të personit që i³ të përgjohet ka të regjistruar një procedim penal, për krime të kryeja. me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pai, në maksimum se dy vjet.

3. Përgjimi me kërkesën e njërit prej dy personave që do të përgjohen mund të autorizohet nga prokurori, vetëm kur sigurohet se personi ka nënshkruar një marrëveshje me oficerin e policisë gjyqësore ku shpreh gatishmërinë për të kryer dhe për të regjistruar veprimin përkatës të përgjimit me personin tjetër.

IV. KOMPETENCA PËR TË AUTORIZUAR PËRGJIMET

1. Procedura normale

1.1 Kompetenca e përgjimit, në kushte normale, gjatë hetimeve paraprake, realizohet, si më poshtë:

1.1.1 Prokurori i kërkon gjykatës autorizimin për të kryer përgjimet e komunikimeve në vendet private dhe gjykata vlerëson dhe autorizon përgjimin me vendim të motivuar, nenet 221/1 dhe 222/1 të K. Pr. Penale;

1.1.2 Prokurori autorizon përgjimin në vende publike, regjistrimin e numrave të telefonit hyrës e dalës, si dhe përdorimin e pajisjeve gjurmuese të vendodhjes së personit, neni 222/1, paragrafi dytë, i K. Pr. Penale;

1.1.3 Prokurori autorizon përgjimin ndërmjet dy personave kur njëri person është i gatshëm ta kryej përgjimin dhe të regjistrojë veprimin përkatës, neni 222/1, paragrafi tretë, i K. Pr. Penale.

2 Procedura e shpejtë

2.1 Kompetenca e përgjimit në raste urgjente ose të ngutshme, realizohet, si më poshtë:

2.1.1 Prokurori vendos drejtpërdrejtë përgjimin me një vendim të

motivuar/arsyetuar, në raste të ngutshme, kur ka arsye të bazuara për të menduar se vonesa mund të sjellë një dëm të rëndë hetimeve. Për vendimin e tij, prokurori duhet të njoftoje menjëherë gjykatën, por jo më vonë se 24 orë.

2.1.2 Gjykata brenda 48 orëve nga vendimi i prokurorit, bën vlerësimin e vendimit të tij, me një vendim të arsyetuar. Në rastet kur vlerësimi nuk bëhet brenda afatit të caktuar dhe/ose kur gjykata nuk miraton vazhdimin e përgjimit, përgjimi ndërpritet dhe rezultatet e tij nuk mund të përdoren.

V. MËNYRA E REALIZIMIT TË PROCESIT TË PËRGJIMIT

Në kryerjen e përgjimeve, respektohen disa rregulla të përgjithshme, të njëjta si në procedurën normale, ashtu dhe në procedurën e shpejtë, si dhe merren masat e duhura, si më poshtë:

1. E drejta për të iniciuar dhe kërkuar përgjimin

1.1 Oficeri i policisë gjyqësore i autorizuar të kryej hetimet paraprake ose veprime të caktuara hetimore inicion tek prokurori ose prokurori kryesisht vlerëson nevojën për të kryer përgjime. Në këto raste oficeri i policisë gjyqësore merr njoftime nga burime të ndryshme informacioni, verifikon dhe përcakton

- 1.1.1 telefonin stacionar, celular a në rrjet, faksin ose mjetet e tjera të komunikimit që përdorin autorët e veprave penale dhe që duhet të përgjohen;
- 1.1.2 adresën e personit, autoveturën e tij, lokalin ose ambientet natyrale, ku takohen dhe ku mund të bisedojnë grupet kriminale në realizimin e veprimtarisë së tyre;
- 1.1.3 të dhëna të tjera lidhur me personin që do të përgjohet, si lidhjet shoqërore e miqësore në veprimtari kriminale, nëse ka qenë i dënuar, etj.

1.2 Kur oficeri i policisë gjyqësore vlerëson se ekzistojnë kriteret ligjore për kryerjen e përgjimit dhe domosdoshmëria për vazhdimin e hetimeve të filluara, përgatit një informacion ose raport për prokurorin, duke përshtatur në të të dhënat e grumbulluara nga verifikimet e bëra.

1.3 Nëse prokurori vlerëson të bazuar kërkesën/rekomandimin e oficerit të policisë gjyqësore, formulon kërkesën për gjykatën, në rastet e procedurës normale ose autorizon përgjimin në raste të ngutshme, duke cituar bazën ligjore dhe çfarë kërkon ose çfarë ka vendosur, numrin e telefonit dhe përdoruesin e tij, mënyrën e kryerjes së përgjimit, kohëzgjatjen e veprimeve, duke iu referuar raportit të oficerit të policisë gjyqësore edhe për hollësitë të tjera. Bashkëlidhur, modelet tip, formularët e printuar dhe në formë elektronike "Kërkesë për Lejim Përgjimi" dhe "Vendim për Lejim Përgjimi".

2. Vendimi që autorizon përgjimin

2.1 Për përgjimet në kompetencë të gjykatës, mbi kërkesën e prokurorit për një seancë të shpejtë gjyqësore, gjykata, verifikon dhe vlerëson ekzistencën e kushteve ligjore, si dhe vendosë për kryerjen ose jo të përgjimit.

2.2 Vendimi i gjykatës që autorizon përgjimin, ose vendimi i prokurorit për përgjimet në kompetencën e tij (nenet 222/1,2,3 të K. Pr. Penale), përkatësisht caktojnë modalitetet, si: llojin e përgjimit, mënyrën e kryerjes së tij, numrat e telefonit që do të vihen në përgjim dhe kohëzgjatjen e përgjimit dhe/ose personat ndaj të cilëve urdhërohet përgjimi, që mund të jenë:

- 2.2.1** të dyshuarit për kryerjen e një veprë penale;
- 2.2.2** personi që dyshohet se merr ose transmeton komunikime nga të dyshuarit;
- 2.2.3** personi që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin, ose
- 2.2.4** personi, vëzhgimi i të cilit mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose të identitetit të dyshuarit.

2.3 Përgjimet në kompetencë të prokurorit, në vecanti përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendodhjes, të autorizohet përdorimi për të lehtësuar kërkimin e personave të fshehur, vecanarisht për autorët e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

3. Kohëzgjatja e përgjimit

3.1 Vendimi i gjykatës ose i prokurorit që autorizon përgjimin, sipas kompetencës që parashikon ligji, caktojnë kohëzgjatjen e përgjimit, duke saktësuar datën dhe/ose orën e fillimit dhe ndërprerjes së përgjimit, i cili nuk mund të kalojë 15 ditë, neni 222/3 i ndryshuar i K. Pr. Penale,

3.2 Kërkesa për zgjatjen e afatit të përgjimit mund të bëhet në çdo kohë, por jo më vonë se tre ditë para përfundimit të afatit të përgjimit dhe duhet të përmbajë në mënyrë të përmbledhur:

3.2.1 rezultatet e arritura nga përgjimi deri në momentin e kërkesës për zgjatje afati;

3.2.2 arsyet, përse vazhdimi i përgjimit është i domosdoshëm për të realizuar detyrat e përcaktuara me ligj, si dhe;

3.2.3 arsyet, përse vazhdimi i lejimit të përgjimit mbetet në proporcion me rezultatet që synohet të arrihen.

3.3 Prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore që kërkon vazhdimin e përgjimit, bashkë me kërkesën për zgjatje afati të përgjimit, sipas rastit i dërgon gjykatës ose prokurorit që do të vendosë për zgjatjen e afatit të përgjimit, materialin e zbardhur të përgjimit deri në momentin që është bërë kërkesa për zgjatje afati, të shoqëruar me një relacion përmbledhës, në

të cilin pasqyrohen momentet më kryesore ku mbështetet kërkesa.

3.4 Mbi kërkesën e motivuar të prokurorit, se ekzistojnë arsyet e kërkuara në fillim të përgjimit, për zgjatjen e afatit të tij, gjykata mund ta zgjasë afatin sa herë është e nevojshme, për periudhe 20 ditëshe kur procedohet për krime dhe 40 ditë kur procedohet për krime të rënda, neni 222/3 i ndryshuar i K. Pr. Penale.

Në rastet kur në rrethana jo të zakonshme, afati i përgjimit ekzistues mbaron përpara se të vendoset zgjatja e afatit të përgjimit, administratori i Sistemit të Përgjimit - i ndodhur në shërbim në kohën e mbarimit të afatit të përgjimit - mban përgjegjësi për të ndërprerë përgjimin, deri në momentin e ardhjes së vendimit, i cili zgjat afatin e përgjimit.

4. Veprimet e përgjimit

4.1 Përgjimi kryhet nga vetë prokurori ose i delegohet, me urdhër të posaçëm, oficerit të policisë gjyqësore të specializuar në këtë fushë, neni 222/4 e 304/2 të K. Pr. Penale. Autorizimi që gjykata i jep oficerit të policisë gjyqësore ose një specialisti të kualifikuar për të hyrë në ambjentet ku do të realizohet përgjimi i fshehtë, fotografik ose me video ose përgjimi i bisedave në vende private, duhet të zbatohet prej tyre brenda 15 ditëve.

4.2 Përgjimet e telekomunikimeve realizohen me anën e paisjeve të Sistemit të Përgjimeve Procedurale Penale, që janë të instaluar në vende të caktuara, në administrim dhe të kontrolluara nga punonjësit e Seksionit të Përgjimit të Telekomunikimeve dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, neni 223/1 e vijues i K. Pr. Penale dhe nenet 13 e 23 të ligjit nr. 9157 datë 4. 12, 2003 "Për përgjimin e telekomunikimeve".

4.2.1 Kopja e vendimit të gjykatës që autorizon përgjimin ose kopja e vendimit të prokurorit që autorizon përgjimin në raste të ngutshme, menjëherë dërgohet në SPTMSHI-ve të kësaj Zyre, e cila gjithashtu menjëherë me një akt zyrtar ia përcjellë për zbatim specialisteve të përgjimit (administratorëve të Sistemit të Përgjimit) dhe oficerëve të policisë gjyqësore të këtij Sektori për realizimin dhe regjistrimin e përgjimit.

4.2.2 Në këtë rast përgjimet realizohen nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore i SPTMSHI-ve të kësaj Zyre, ndërsa specialisti i përgjimeve luan rolin e asistentit teknik pa u vënë në dijeni të rezultateve të përgjimit.

4.3 Kërkesat e prokurorëve për regjistrime të numrave të telefonit (tabulate të bisedave), hyrës dhe dalës, e-mail apo shërbime të tjera që mund të ofrohen prej kompanive të telefonisë celulare A.M.C., Vodafone ose Telekom duhet t'i dërgohen menjëherë SPTMSHI-ve të kësaj Zyre, i cili ndjek dhe është ndërmjetës i prokurorëve dhe këtyre kompanive për kërkimin dhe marrjen e të dhënave në interes të hetimit. SPTMSHI-ve i kësaj Zyre, përgjigjet e ardhura nga kompanitë AMC, Vodafone ose Telekom menjëherë ia përcjellë Prokurorise që ka parashtruar kërkesën.

5. Ndalimi i përgjimit

5.1 Në rastet kur njeri nga kushtet e përgjimit të permendura në **Seksionizi III** të këtij udhëzimi nuk ekziston më, me kërkesën e mehjëhershme të bërë me shkrim nga oficeri i policisë gjyqësore që ka inicuar dhe/ose ndjek përgjimin, prokurori që ndjek procedurën menjëherë urdhëron ndalimin e përgjimit dhe vë në dijeni gjykatën kur urdhëri është dhënë nga gjykata, neni 223 pika 1/1 e K. Pr. Penale.

5.2 Kopja e urdhërit për ndalimin e përgjimit menjëherë i dërgohet SPTMSHI-ve të kësaj Zyre, i cili menjëherë ia përcjellë për zbatim administratorëve të Sistemit të Përgjimit.

5.2.1 Me marrjen njoftim për ndalimin e përgjimit, administratori i Sistemit të Përgjimit, menjëherë, ndërpret përgjimin.

5.2.2 Në rastet kur është kërkuar ndihma e operatorëve të shërbimit të telekomunikimit, SPTMSHI-ve i kësaj Zyre i njofton ato për urdhrin që ndalon përgjimin, sa më parë që të jetë e mundur por jo më vonë se pas tre ditësh.

6. Regjistri i përgjimit

6.1 Në Prokuroritë e shkallës së parë dhe në SPTMSHI-ve të kësaj Zyre të mbahet një regjistër i unifikuar "Regjistri për Përgjimef. Bashkëlidhur, modeli tip, formulari i printuar dhe në formë elektronike i "Regjistrin për Përgjimet".

6.2 Prokurori dhe/ose oficeri i policisë gjyqësore i ngarkuar për administrimin e këtij regjistri, mban sipas renditjes kronologjike të tyre, gjithë aktet, vendimet ose urdhërat, me të cilat është autorizuar, vlerësuar ose zgatur afati i përgjimeve, ndaluar përgjirni dhe kohën e fillimit dhe të përfundimit të çdo përgjimi, neni 222/5 i K. Pr. Penale.

6.3 Regjistri duhet të plotësohet në kohë dhe me saktësi në të gjithë ekstremitetet e tij, për të shmangur abuzimet dhe pavlefshmëritë që mund të ngrihen për këtë shkak nga palët e interesuara.

7. Procesverbali i transkriptimit

7.1 Në përfundim të procesit të përgjimit, sipas afateve të përcaktuara, oficeret e policisë gjyqësore të specializuar në këtë fushë, të cilët kanë bërë regjistrimin e përgjimeve bëjnë transkriptimin në procesverbal të komunikimeve të përgjuara, ku në mënyrë të përmbledhur:

7.1.1 Transkriptohet përmbajtja e bisedave që janë regjistruar, neni 223/2 i K. Pr. Penale;

7.1.2 Transkriptimi që bën oficeri i policisë gjyqësore i specializuar, duhet të jete aq i detajuar sa të ndihmojë për të kuptuar bisedën që është dëgjuar, duke e shkruar siç është dëgjuar, çka lidhet me objektivitetin e tij;

7.1.3 Interpretimi i bisedës së përgjuar bëhet vetëm nga gjykata.

7.2 Në përfundim të përgjimit të telekomunikimeve që realizohen nga SPTMSHI-ve i kësaj Zyre, oficerët e policisë gjyqësore që kanë kryer regjistrimin në CD bëjnë dhe procesverbalin e transkriptimit. Procesverbali i transkriptimit dhe CD-ja përkatëse me një akt zyrtarë SPTMSHI-ve të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm i dërgohet prokurorisë përkatëse brenda 7 (shtate) ditëve nga përfundimi i përgjimit.

7.3 Në hartimin e procesverbalit, duhet të tregohet kujdesi i duhur, për të fiksuar:

7.3.1 Në pjesën hyrëse tregohet:

- vendi, data dhe personi, oficeri i policisë gjyqësore, që ka kryer transkriptimin;
- numri dhe data e vendimit që ka autorizuar përgjimin dhe baza ligjore e veprimit të fiksimit në procesverbal;
- ambienti ose telefoni stacionar, celular a në rrjetë ose mjete të komunikimit të përgjuar;
- data dhe ora e fillimit dhe e ndërprerjes së përgjimit;
- mënyra e kryerjes së regjistrimit të bisedave ose komunikimeve.

7.3.2 Në pjesën përshkruese tregohet:

- përmbajtja e bisedave që janë regjistruar, me detajimet e nevojshme që ndihmojnë për të kuptuar bisedën që është dëgjuar;
- bisedat e veçanta që janë përgjuar, duke respektuar rendin kronologjik, kohën e kryerjes së tyre dhe emërtimi i bobinave/CD kuato janë regjistruar;
- inicialet e personave të njohur objekt përgjimi dhe për bashkëbiseduesit, karakteristikat e dallueshme të zërit;
- biseda duhet të shkruhet siç është dëgjuar, me difektet në shqiptim, etj. Kjo është shumë e rëndësishme dhe lidhet me objektivitetin e transkriptimit,

7.3.3 Në pjesën e përfundimit, tregohet;

- përshkrimi i emertimeve të bobinave/CD të regjistruara që u transkriptuan;
- ora e fillimit dhe e përfundimit të transkriptimit dhe nënshkrimi.

7.4 Në hetimet paraprake ose gjatë shqj'rtimit gjyqësor, mund të kërkohet ndihma e eksperteve sipas fushave;

7.4.1 për ekspertimin kriminalistik të zërit, me synim përcaktimiri e seksit, nëse zëri është Qriginal apo i manipuluar, deri dhe identifikimin e personit në bazë të zërit dhe të folurit, dhe/ose;

7.4.2 për përkthimin e bisedave të bëra në gjuhë të huaj, etj.

8. Përfundimi i përgjimit

8.1 Në përfundim të veprimtarisë teknike të përgjimit:

8.1.1 procesverbali i transkriptimit dhe regjistrimet duhet t'i dorëzohen pa vonesë prokurorit që ndjek procedimin;

8.1.2 prokurorij brenda 5 ditëve nga mbarimi i veprimeve, duhet të depozitojë në sekretari, procesverbalet dhe regjistrimet, bashkë me aktet që kanë urdhëruan, autorizuan, vlerësuan ose zgjatur përgjimin;

8.1.3 në rastet kur prokuror i cmon se nga dorëzimi në sekretari i akteve mund të demtohen hetimet, ai i kërkon gjykatës shtyrjen depozitimit deri në përfundimin e hetimeve, neni 223/3 i K. Pr, Penale.

8.2 Pasi është bërë depozitimi në sekretari, menjëherë prokurori duhet të njoftojë avokatët mbrojtës dhe përfaqësuesit e palëve, të cilët kanë të drejtën e tyre për të shqyrtuar aktet dhe për tu njohur nëpërmjet dëgjimit, me përmbajtjen e regjistrimeve të depozituara, brenda afateve të caktuara nga ana e tij, neni 223/4 i K. Pr. Penale.

8.3. Në raste urgjente ose me procedurë të shpejtë, siç mund të jenë rastet e veprimtarisë së grupeve të strukturura ose të organizuara që kryejnë trafik të narkotikeve, kiandestinëve, prostitucionit, etj, për shkak se pjesëmarrësit në këto veprimtari kriminale ndryshojnë shumë shpejt dhe shpesh numrat e telefoneve, kur përgjimi urdhërohet nga prokurori, nenet 222/2 e 224 të K. Pr. Penale dhe kur përgjimet shoqërojnë veprimet simuluese ose punonjësin e policisë të infiltruar, nenet 294/a e 294/b të K. Pr. Penale dhe ligji 8750 datë 26. 03. 2001 "Për parandalimin dhe luftën ndaj substancave narkotike ose psikotrope" zbatohen edhe këto rregulla:

8.3.1 procesverbalet dhe regjistrimet do të ruhen në zyrën e prokurorit që ndjek çështjen, derisa vendimi të marrë formë të prerë, përveç atyre që ndalohet përdorimi, ose;

8.3.2 kur ky dokumentim nuk është i nevojshëm, personi i interesuar mund të kërkojë në gjykatë asgjësimin e tyre dhe mbi këtë kërkesë vendos gjykata.

VI SKEMA E FLUKSEVE TELEFONIKE.

1. Rezultatet e përgjimit, vecanarisht, në hetimet e kriminalitetit të organizuar, grupeve të strukturuar, kriminit ekonomik dhe korrupsionit, mund të jene të dobishme për të ndërtuar një bazë të dhënash mbi subjektet në hetim, si:

1.1 renditja e lidhjeve, takimeve, zakoneve të tyre;

1.2 tipologjia e veprimtarisë kriminale dhe mënyrat e fshehjes së saj;

1.3 banesa, lokali, ambjenti ose autovetura e subjektit në një moment të caktuar;

1.4 struktura dhe hierarkia e grupit ose organizatës.

1.5 detyrat dhe funksionet që kryen secili pjestarë i kësaj veprimtarie

kriminale, etj.

2. Analiza e këtyre të dhënave të nxjerra nga përgjimi i veprimtarisë kriminale mund të bëhet shumë e efektshme, kur realizohet në formën e një skeme të posaçme, për përpunimin e së cilës kërkohet vemendje e duhur në drejtimet si më poshtë:

2.1 Fillimishtë, përzgjidhen telefonatat më të rëndësishme që kanë efektivisht lidhje me hetimin;

2.2 Shqyrtimi i përgjimeve telefonike mund të nxjerrë një rra dhe njëoftimesh të dobishme, për përcaktimin e lidhjeve midis pjesarëve të veprimtarisë kriminale, lëvizjet e telefonave celularë nga përdoruesit etj,

2.3 Analiza në ecurinë e pikave të kontaktit të telefonit celular në përgjim, me telefona të ndryshëm bën të mundur të rindërtohet e gjithë rruga që ka kryer autori i veprimtarisë kriminale, si: vendet, oraxet, personat me të cilët ka folur.etj.

3. Për të lehtësuar vështirësitë praktike në analizën e të dhënave të bisedave të përgjuara është e domosdoshme përdorimi i programeve të posaçme informatike me asistencën dhe ndihmën metodike të SPTMSHI-ve të kësaj Zyre, siç mund të jenë:

3.1 Programi "Excel" i Windows-it, me anë të cilit është e mundur ripërpunimi i të dhënave në mënyrë mjaft eficiente;

3.2 Programi "Analyst's Notebook", i cili është i një niveli më të lartë dhe bën të mundur përpunim të shpejtë dhe efikas të çdo lloji të dhënash, si dhe shikimin dhe kuptimin e menjëhershëm të ndërlidhjeve telefonike midis disa subjekteve, të shoqëruar dhe me skemën e lidhjeve të të gjitha të dhënave që zotëron operatori;

3.3 Programi "I-Connect", gjithashtu, bën të mundur shkëmbim e informacioneve midis një burimi të dhënash, siç mund të jetë ardhvi i vetë programit, duke lejuar krijimin e një kuadri të qartë të elementeve të njohur, shoqëruar me skemën e lidhjeve.

VII. RREGULLAT PËR RUAJTJEN E SEKRETIT DHE TË DOKUMENTACIONIT TË DALË NGA PROCESI I PËRGJIMIT

1. Njohja me aktet/materialin e përgjimit dhe trajtimi i tij.

1.1 SPTMSHI-ve i kësaj Zyre dhe oficerët e policisë gjyqësore të specializuar në këtë fushë, krahas detyrimit për përgatitjen në kohë të transkripteve të shkruara të materialit të përgjuar, sipas metodave më moderne, të garantojë dërgimin e menjëhershëm të tyre subjektit që ka kërkuar përgjimin.

1.1.1 Numri i personave, të cilët mund të njihen me materialin e përgjuar duhet të jetë sa më i kufizuar.

1.1.2 Materiali i përgjuar nuk duhet t'i vihet në dispozicion asnjë personi, i cili nuk ka kërkesë zyrtare ose nuk është i autorizuar për të marrë këtë informacion.

1.2 Në mënyrë të përmbledhur disa rregulla të unifikuara që mund të përdoren, për të shmangur njohjen e akteve/materjaleve nga personat e paautorizuar mund të jenë:

1.2.1 Oficeri i policisë gjyqësore kërkesat/aktet e lidhura me përgjimin që inicion prokurori klasifikohen sekret, i mbyllë në zarf të fulosur ku shënon ekstremitetet e kërkesës/aktit (sekret, nr.prot, datën dhe prokurorit që i drejtohet) dhe nëpërmjet sekretarisë e degon në Prokurori.

1.2.2. Sekretaria e Prokurorisë përkëtesë, në këto raste protokollon ekstremitetet e të dhënave të pasqyruara në zarf dhe zarfin e pa hapur ia kalon vetëm drejtuesit të prokurorisë ose prokurorit që i adresohet praktika,

1.2.3 Prokurori që ndjek procedimin, kërkesat/aktet e klasifikuara sekret të dhura me përgjimin, të cilët i dërgon në gjykatë ose në institucione të tjera të autorizura, i mbyllë në zarf të fulosur ku shënon ekstremitetet e aktit (sekret, nr.prot, datën dhe institucioni prokurorit që i drejtohet) dhe nëpërmjet sekretarisë, siç përshkruhet **në pikën 1,2.2 më sipër**, ia dërgon gjyqtarit ose institucionin përkatës.

1.2.4 Kjo praktike të rekomandohet të ndiqet edhe nga gjyqtari që autorizon me vendim përgjimin, që zgjat afatin e përgjimit apo për akte të tjera të klasifikuara që lidhen me përgjimin,

1.3. Në çdo kohë, si gjatë përgjimit, ashtu dhe pas përfundimit të tij, prokurori që ndjek çështjen ose oficeri i policisë gjyqësore i autorizuar prej tij mund të kërkojë të njihet me rezultatet e përgjimit dhe me kopje të të gjithë transkripteve të nxjerra.

1.4 SPTMSHI-ve i kësaj Zyre, veç materialit të ruajtur ne kompjuter dhe në audio, mban një" kopje te transkripteve, deri në kohën kur rrierr njoftim për asgjësimin e materialit të urdhëruar nga gjykata, sipas rregullave që parashikojnë nenet 224 e 226/3 të K. Pr, Penale.

1.5 Prokurori që ka kërkuar përgjimin dhe çdo person tjetër që zotëron materialin e përgjuar është i detyruar:

1.5.1 për të garantuar që materiali t'u jepet vetëm personave që' ai është i bindur se kanë një kërkesë zyrtare për ta marr atë;

1.5.2 të sigurojë që është mbajtur një regjistër, ne të cilin shënohen të gjithë personat që u është dhenë materiali.

2. Rregullat për mbajtjen e sekretit

2.1 Të gjithë aktet procedurale penale, regjistrat dhe shkresat përcjellëse që lidhen me përgjimet janë dokumenta të klasifikuar "Sekret", deri në momentin kur u bëhen të njohura mbrojtësve dhe përfaqësuesit të palëve. Administrimi, ruajtja, nxjerrja dhe asgjësimi i tij bëhet ne zbatim të ligjit "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror" dhe nenin 223/4 e vijues të K, Pr. Penale, si dhe të këtij udhëzimi.

2.2 Ruajtja e sekretit në realizimin e përgjimit, që në momentin e inicimit të kërkeses për përgjim nga oficeri i policisë gjyqësore, deri në momentin kur bëhet lajmërimi i mbrojtësit apo përfaqësuesit të palëve për tu njohur me to, është mjete kryesor për arritjen e qëllimit.

2.3 Shkelja e rregullave për administrimin, ruajtjen, nxjerrjen dhe asgjесimin e çdo materiali të përgjimit përbën shkelje të këtij ligji dhe ligjit "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror" dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

VIII PËRDORIMI REZULTATEVE TË PËRGJIMIT

1. Përgjimi i bisedimeve, komunikimeve telefonike dhe i formave të tjera të telekomunikimit është i vlefshëm/përdorshëm për të gjithë komunikuesit, dmth si për personin objekt përgjimi ashtu dhe për personat e tjerë që komunikojnë me të, neni 221/4 i ndryshuar i K. Pr. Penale.

2. Rezultatet e përgjimit kanë vlerë dhe mund të përdoren për procedime të ndryshme, dmth në procedime të tjera, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm që parashikon papërdorshmërinë, vetëm kur janë të domosdoshme për verifikimin dhe hetimin e krimeve, neni 225 i ndryshuar i K. Pr. Penale. Në këto raste, procesverbalet dhe rregjistrimet e përgjimeve, i dorëzohen autoritetit tjetër që procedon.

3. Prokurorët duhet të bëjnë kujdes në vlerësimin e rasteve që ndalohet dhe nuk mund të përdoren rezultatet e përgjimit të bisedave ose komunikimeve, të cilët mund të jenë kur:

3.1 përgjimet janë kryer jashtë rasteve të lejuara me ligj;

3.2 nuk janë respektuar dispozitat e parashikuara në nenet 221-226 të K. Pr. penale, për përgjimet;

3.3 personat që janë përgjuar kanë detyrim ligjor të ruajnë sekretin për shkak të profesionit ose detyrës, si:

3.3.1 përfaqësuesit e besimeve fetare, avokatët, noferët, përfaqësuesit ligjor, mjekët, kirurgët, farmacistët, opstetrët, etj;

3.3.2 nëpunësit shtetërorë, nëpunësit publik që administrojnë fakte sekret shtetërorë, duke përjashtuar rastet kur këto persona kanë dhënë shpjegime për të njëjtat fakte, ose kur i kanë përhapur ato në ndonjë mënyrë tjetër, nenet 226, 52/4, 159 e 160 të K. Pr. Penale.

4. Regjistrimet dhe procesverbalet e përgjimit që do të konsiderohen si të papërdorshëm, me urdhër të gjykatës kryhet asgjесimi i tyre, në çfarëdo gjendje apo faze të procedimit penal, me përjashtim të faktit kur këto përbëjnë provë materjale, neni 226/3 i K. Pr. Penale.

5. Procesverbalet dhe regjistrimet e përgjimit të bisedave ose komunikimeve, të quajtura "përgjime indirekte", nuk mund të përdoren pjesërishtë, në fragmentet e bisedave të personave objekt përgjimi, me persona për të cilët kërkohet autorizimi për procedim, neni 289/1 i K. Pr. Penale.

6. Në rastet kur procedohet me përgjim kundër disa personave, për njerin prej të cilëve është i domosdoshëm autorizimi për procedim dhe ky autorizimi është kërkuar por nuk është dhënë ose është vonuar nga institucioni përkatës, regjistrimet dhe procesverbalet e përgjimeve për personat e tjerë që nuk kërkohet autorizimi, mund të përdoren vetëm kundër atyre personave që autorizimi nuk është i nevojshëm, neni 289/2 i K. Pr. Penale.

IX. MËNYRA E RUAJTJES DHE ASGJËSIMIT TË MATERJALEVE TË PËRGJIMIT

1. Në përfundim të përgjimit procesverbalet dhe regjistrimet në CD ruhen pranë prokurorisë që ka urdheruar përgjimin dhe në SPTMSffl-ve të kësaj Zyre derisa vendimi të marrë formë të prerë, me përjashtim të atyre që ndalohet përdorimi.

2. Në rastet kur ky dokumentacion nuk është i nevojshëm, mbi kërkesën e të interesuarit gjykata që ka bërë vleftësimin e përgjimit vendosë për asgjësimin e procesverbaleve dhe regjistrimeve, procesi cili realizohet nga prokurori që ndjek procedimin në praninë e përfaqësuesit të SPTMSHI-ve të kësaj Zyre, nën kontrollin e gjyqtarit dhe për veprimin mbahet procesverbal. Në rastet kur prokurori në përfundim të hetimeve që ka përfunduar përgjimin vendos pushimin e çështjes, për këtë vendim njofton me shkrim gjykatën, e cila vendos për asgjësimin e procesverbaleve dhe regjistrimeve në afatin e caktuar prej saj dhe vë në dijeni personin e përgjuar.

3. Prokurorët, gjithashtu, të bëjnë kujdes për të vlerësuar se përgjime relativisht të pavlefshme mund të kemi në rastet kur:

3.1 Evidentohen gabime materjale ose mungesa e firmës në regjistrime të përgjimeve që mban prokurori ose në procesverbalet e transkriptimit, nenet 222/5, 223/2, 122 e 129/1 të K. Pr. Penale.

4. Prokurorët dhe oficeret e policisë gjyqësore që kryejnë përgjimin e bisedave ose komunikimeve, në kryerjen e këtij veprimi shumë delikat dhe të rëndësishëm, që është një nga format me efikasitet në zbulimin dhe provueshmërinë e kriminalitetit, vërejtëse atij të organizuar, ekonomik dhe korrupsionit, duhet të jenë shumë të vemendshëm në respektimin e dispozitave ligjore dhe rregullave rigorozisht të përcaktuara, për të mos rrezikuar pavlefshmerinë e përgjimit dhe të provave të rëndësishme që rrjedhin prej tij, duke garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të

individit.

XI. ZBATIMI DHE HYRJA NË FUQI

1. Me këtë udhëzim të njihen oficerët e policisë gjyqësore dhe punonjësit e SPTMSHI-ve të kësaj Zyre, prokurorët dhe drejtuesit e Prokurive të të gjithë niveleve.

2. Për të' ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij udhezimi ngarkohen prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjitha niveleve, strukturat e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe në veçanti SPTMSHI-ve pranë kësaj Zyre.

3. Mospërbushja e detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim, nëse nuk përbën vepër penale, përbën shkelje të disiplinës në punë.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

THEODHORI SOLLAKU



